

MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

Nr. ____ Prot. më ____ / ____ /2020

UNIVERSITETI I MJEKËSISË
TIRANË

Nr. ____ Prot. më ____ / ____ /2020

URDHËR

PËR

**ORGANIZIMIN E TRAJNIMEVE TË PERSONELIT MJEKËSOR DHE
INFERMIEROR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 6, pika 1, gërmat "ë" të Ligjit Nr.15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" në kuadër të shpalljes së gjendjes së epidemisë me Urdhërin nr. 156/2 datë 11.03.2020, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJMË:

1. Spitalet Universitare, Spitalet Rajonale dhe Spitalet Bashkiake të marrin të gjitha masat për të organizuar trajnimin e të gjithë personelit mjekësor dhe infermieror, sipas programeve të miratuara nga Universiteti i Mjekësisë Tiranë, të cilin e gjeni bashklidhur.
2. Në Spitalet Rajonale të Durrësit, Shkodrës, Elbasanit, Korçës, Vlorës dhe QSUT-së, trajnimi do të realizohet në bashkëpunim me Universitetet përkatëse pranë këtyre qyteteve
3. Trajnimet e personelit mjekësor dhe infermieror, sipas pikës 2 të këtij urdhëri do të zhvillohen në ambjentet e Universitetit të Mjekësisë Tiranë, Universitetit "Fan Noli" Korçë, Universitetit "Luigj Gurakuqi" Shkodër, Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, Universitetit "Aleksandër Xhuvani" Elbasan, Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.
4. Ekipet që do të trajnohen nuk duhet të jenë më shumë se 5 (pesë) persona duke ruajtur distancat e sigurisë dhe duke qënë të mbrojtur.
5. Në mënyrë të planifikuar, i gjithë stafi mjekësor duhet të kalojë të paktën një ditë pune në terapi intensive, për të përfutur shprehi praktike.

6. Spitalet dhe Universitetet e përmendura në këtë urdhër, duhet të caktojnë një koordinator për të bashkërenduar punën për organizimin e trajnimeve.
7. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhëri Spitalet Universitare, Rajonale, Bashkiake, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe Universitet e përcaktuara në këtë urdhër.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI I UNIVERSITETIT

TË MJEKËSISË

Koordinator Përgjegjës për Organizimin, Trajnimin

Dhe Administrimin e Burimeve Njerëzore

Ekzistuese dhe Vullnetare

Prof. Arben Gjata

MINISTRI

Ogerta Manastirliu

Konceptoi: N. Kodra
Mirator: A. Njehrrina
Konfirmoi: G. Prodanj
Date: _____ 2020
Kopje: 3 (tre)